

PROGRAMI DHE PYETJET I GJUHËS PËR PROVIMIN E SHTETIT NË MËSUESI

HYRJE NË GJUHËSI

1. Vendi i gjuhësisë në shkencat e tjera
2. Gjuha, veçoritë dhe funksionet e saj
3. Konceptet themelore të gjuhësisë

Literatura:

R. Memushaj, Hyrje në gjuhësi, Tiranë 2006

PYETJET

1) Cili funksion i gjuhës lidhet me “dhënësin” e informacionit?

- a. ekspresiv b. referencial c. konativ d. fatik

2) Cili funksion i gjuhës lidhet me “marrësin” e informacionit?

- a. konativ b. referencial c. metagjuhësor d. fatik

3) Cili funksion i gjuhës lidhet me “kodin” e informacionit?

- a. konativ b. referencial c. metagjuhësor d. fatik

4) Cili funksion i gjuhës lidhet me “kanalin e komunikimit” e informacionit?

- a. poetik b. referencial c. metagjuhësor d. fatik

5) Cili funksion i gjuhës lidhet me “referentin” e informacionit?

- a. poetik b. referencial c. metagjuhësor d. fatik

6) Cili funksion i gjuhës lidhet me “mesazhin” e informacionit?

- a. poetik b. referencial c. metagjuhësor d. fatik

7) Kur thuhet se personi i duhur duhur duhet të thotë fjalët e duhura, në vendin dhe në kohën e duhur, i referohemi funksionit?

- a. performativ b. referencial c. poetik d. ekspresiv

8) Cili përkufizim është i saktë:

- a. Gjuhësia mund të përkufizohet si *shkenca që merret me studimin sistemor të gjuhës.*
- b. Gjuhësia mund të përkufizohet si *shkenca që merret me studimin e gjuhës.*
- c. Gjuhësia mund të përkufizohet si *shkenca që sistematikisht studion gjuhën.*
- d. Gjuhësia mund të përkufizohet si *shkenca që ka si objekt studimin e gjuhës.*

9) Cilat disiplina përfshihen në mikrolinguistikë:

- a. fonetikë nyjëtimore, dialektologji, semiologji
- b. fonologji, morfologji, semantikë
- c. sociolinguistikë, psikolinguistikë, neurolinguistikë
- d. gjuhësi matematikore, gjuhësikompjuterike, gjuhësi statistikore

10) Cila disiplinë nuk përfshihet në makrolinguistikë:

- a. fonetikë nyjëtimore
- b. fonetikë funksionale
- c. fonetikë akustike
- d. fonetikë dëgjimore

11) Në fjalinë “ Hape derën!”, cili funksion mbizotëron?

- a. konativ
- b. fatik
- c. ekspresiv
- d. metagjuhësor

12) Në fjalinë “Mirë se ju gjej!”, cili funksion mbizotëron?

- a. konativ
- b. fatik
- c. ekspresiv
- d. metagjuhësor

13) Në fjalinë “Çfarë është zgjedhimi i foljes!”, cili funksion mbizotëron?

- a. konativ
- b. fatik
- c. ekspresiv
- d. metagjuhësor

14) Cili është funksioni që gjuha jonë ka të përbashkët me komunikimin mes kafshëve?

- a. konativ
- b. fatik
- c. ekspresiv
- d. metagjuhësor

15) Në fjalinë “Alo!”, cili funksion mbizotëron?

- a. konativ
- b. fatik
- c. ekspresiv
- d. metagjuhësor

16) Në fjalinë “Ç’domethënë akt ligjërimor?”, cili funksion mbizotëron?

- a. konativ
- b. fatik
- c. metagjuhësor
- d. konativ

17) Arbitrariteti i shenjës gjuhësore lidhet me:

- a. karakterin performativ të gjuhës
- b. funksionin njohës të gjuhës
- c. karakterin marrëveshjesor të gjuhës
- d. funksionin fatik të gjuhës

18) Karakteri abstrakt i gjuhës njerëzore është veçori edhe e:

- a. “gjuhës” së bletëve
- b. “gjuhës” së qenve
- c. “gjuhës” së ujqërve
- d. “gjuhës” së mizave

19) Sipas Çomskit, çfarë trashëgojmë ne?

- a. gjuhën
- b. performancën
- c. ligjërimin
- d. kompetencën

20) Merita për identifikimin e shenjës dhe të shenjuarit tek shenja gjuhësore është e:

- a. Çomskit
- b. Sosyrit
- c. Martinesë
- d. Humbodtit

21) Cila nga shenjat e mëposhtme gjuhësore është arbitrare:

- a. murator
- b. bubullimë
- c. bubullin
- d. mur

22) Studimin e shenjës gjuhësore në tri anët e saj e propozoi:

- a. Sosyri
- b. Martineja
- c. Morrisi
- d. Hjelmslevi

23) Cila nga shenjat e mëposhtme gjuhësore nuk është arbitrare:

- a. shtëpi

- b. shteg
- c. shkruaj
- d. shkrim

24) Duke pasur parasysh se ligjërimi (sipas Martinesë) është dyfish i nyjëtuar, gjeni njësinë e nyjëtimimit të dytë:

- a. fonema
- b. morfema
- c. fjala
- d. sintagma

25) Cili prej pohimeve është i vërtetë?

- a. Njësitë e nyjëtimimit të parë i kanë të dyja anët: formën ose *planin e shprehjes*, dhe përmbajtjen ose *planin e përmbajtjes*.
- b. Njësitë e nyjëtimimit të parë kanë vetëm një anë, formën ose *planin e shprehjes*
- c. Njësitë e nyjëtimimit të parë i kanë vetëm një anë, përmbajtjen ose *planin e përmbajtjes*.
- d. Njësitë e nyjëtimimit të parë i kanë vetëm një anë: formën, apo *planin e shprehjes* ose përmbajtjen, apo *planin e përmbajtjes*.

26) Shenjat e gjuhës janë:

- a. ikona
- b. simbole
- c. simptoma
- d. formula

27) Cila prej këtyre njësive të gjuhës është njësi kumtuese?

- a. fjala
- b. fonema
- c. fjalia
- d. grupi sintaksor

28) Cila prej këtyre njësive të gjuhës nuk është njësi ndërtuese?

- a. fonema
- b. morfema
- c. grupi sintaksor
- d. fjala

29) Cila prej këtyre njësive të gjuhës është njësi quajtëse?

- a. fonema
- b. morfema
- c. grupi sintaksor
- d. fjala

30) Lidhjet paradigmatiche realizohen mes njësish:

- a. heterogjene
- b. të afërta

- c. homogjene
- d. të llojeve të ndryshme

31) Sipas metodës së përndarjes (distribucionit), kemi të bëjmë me shfaqje të ndryshme të së njëjtës njësi nëse:

- a. dy tinguj ose vargje tingullore të ngjashme fonetikisht mund të përdoren në vend të njëri-tjetrit në të njëjtin pozicion të sintagmës
- b. dy tinguj ose vargje tingullore të ngjashme fonetikisht nuk mund të përdoren në vend të njëri-tjetrit në të njëjtin pozicion të sintagmës
- c. dy tinguj ose vargje tingullore të ngjashme fonetikisht nuk mund të përdoren në vend të njëri-tjetrit në pozicione të ndryshme të sintagmës
- d. dy tinguj ose vargje tingullore të ngjashme fonetikisht mund të përdoren në vend të njëri-tjetrit në pozicione të ndryshme të sintagmës

32) Çfarë është një sistem shenjash, sipas Sosyrit?

- a. kompetenca
- b. performanca
- c. gjuha
- d. ligjërimi

33) Karakteri *linear* është veçori e:

- a. gjuhës
- b. ligjërimin
- c. gjuhës dhe ligjërimin
- d. asnjërës

34) Cila prej këtyre veçorive nuk i përket gjuhës?

- a. potenciale
- b. shoqërore
- c. sistemore
- d. individuale

35) Shenja gjuhësore shënon:

- a. diçka të njëjtë me veten
- b. diçka të ndryshme nga vetja
- c. formën e planit të përmbajtjes
- d. formën e planit të shprehjes

36) Sintaksa ka për objekt:

- a. marrëdhënien e shenjës me përdoruesin
- b. marrëdhënien e shenjës me shenjat e tjera
- c. marrëdhënien e shenjës me të shënuarin
- d. marrëdhënien e shënuesit me të shënuarin

37) Cila prej këtyre njësive nuk i përket gjuhës, por ligjërimin:

- a. fonema

- b. morfema
- c. fjala
- d. thënia

38) Cila prej këtyre njësive nuk i përket ligjërimit, por gjuhës:

- a. tingulli
- b. morfema
- c. fjala fonetike
- d. thënia

39) Pohimi se “kundërvënia r-rr nuk shtë karakteristike për shqipen e sotme” përbën një studim:

- a. historik
- b. diakronik
- c. sinkronik
- d. hitoriko-krahasues

40) Pohimi se “kundërvënia r-rr po shkon drejt zhdukjes” në fushën e gjuhësisë:

- a. historike
- b. përshkruese
- c. sinkronike
- d. përqasëse

FONETIKË DHE FONOLOGJI

1. Tiparet nyjetimore të sistemit fonologjik të shqipes
2. Fonologjia mbisegmentore dhe prozodia (rrokja, theksi, intonacioni)
3. Ndërrimet dhe ndryshimet fonemore

Literatura:

R. Memushaj, Fonetika e shqipes standarde, Tiranë 2010

PYETJET

1) Fonetika studion:

- a. Formën e planit të shprehjes
- b. Formën e planit të përmbajtjes
- c. Substancën e planit të shprehjes
- d. Substancën e planit të përmbajtjes

2) Fonologjia studion:

- a. Formën e planit të shprehjes

- b. Formën e planit të përmbajtjes
- c. Substancën e planit të shprehjes
- d. Substancën e planit të përmbajtjes

3) Zanoret formohen nga:

- a. Kalimi i lirë i tonit laringal në zgavrat e mbi laringut
- b. Kalimi i tonit laringal, duke hasur pengesa në zgavrat e mbilaringut
- c. Kalimi i lirë i zhurmës laringale
- d. Kalimi i zhurmës laringale, duke hasur pengesa në zgavrat e mbilaringut

4) Bashkëtingëlloret formohen nga:

- a. Kalimi i lirë i tonit laringal në zgavrat e mbi laringut
- b. Kalimi i tonit laringal, duke hasur pengesa në zgavrat e mbilaringut
- c. Kalimi i lirë i zhurmës laringale
- d. Kalimi i zhurmës laringale, duke hasur pengesa në zgavrat e mbilaringut

5) Zanorja [e] ka këto tipare nyjëtimore:

- a. gjysmë e mbyllur, buzore, e përparme
- b. gjysmë e mbyllur, jobuzore, e përparme
- c. gjysmë e hapur, buzore, e përparme
- d. gjysmë e hapur, jobuzore, e përparme

6) Zanorja [o] ka këto tipare nyjëtimore:

- a. gjysmë e mbyllur, buzore, e prapme
- b. gjysmë e mbyllur, jobuzore, e prapme
- c. gjysmë e hapur, buzore, e përparme
- d. gjysmë e hapur, jobuzore, e përparme

7) Zanorja [y] ka këto tipare nyjëtimore:

- a. e mbyllur, buzore, e prapme
- b. e mbyllur, buzore, e përparme
- c. e mbyllur, jobuzore, e përparme
- d. e mbyllur, jobuzore, e prapme

8) Zanorja [i] ka këto tipare nyjëtimore:

- a. e mbyllur, buzore, e prapme
- b. gjysmë e mbyllur, buzore, e përparme
- c. e mbyllur, jobuzore, e përparme
- d. gjysmë e mbyllur, jobuzore, e përparme

9) Bashkëtingëllorja [b] ka këto tipare nyjëtimore:

- a. dybuzore, mbylltore, e zëshme
- b. dybuzore, shtegore, e zëshme
- c. buzore, mbylltore, e zëshme
- d. buzore, shtegore, e zëshme

10) Bashkëtingëllorja [f] ka këto tipare nyjëtimore:

- a. buzore-dhëmbore, mbylltore, e shurdhët
- b. buzore-dhëmbore, mbylltore, e zëshme
- c. buzore-dhëmbore, shtegore, e shurdhët
- d. buzore-dhëmbore, shtegore, e zëshme

11) Bashkëtingëllorja [m] ka këto tipare nyjëtimore:

- a. dybuzore, mbylltore, hundore, e tingullt
- b. buzore, mbylltore, hundore, e zëshme
- c. dybuzore, hundore, e tingullt
- d. dybuzore, shtegore, hundore, e tingullt

12) Bashkëtingëllorja [j] ka këto tipare nyjëtimore:

- a. qiellzore, mbylltore, e shurdhët, anësore
- b. qiellzore, shtegore, e tingullt, mesore
- c. alveoqiellzore, shtegore, e shurdhët, anësore
- d. qiellzore, mbylltore, e tingullt, mesore

13) Cila fonemë ka këto tipare: mbylltore, velare, e shurdhët

- a. /q/
- b. /k/
- c. /h/
- d. /g/

14) Cila fonemë ka këto tipare: mbylltore, qiellzore, e shurdhët

- a. /q/
- b. /j/
- c. /h/
- d. /k/

15) Cila fonemë ka këto tipare: shtegore, anësore, e tingullt, e pavelarizuar

- a. /ll/
- b. /j/
- c. /l/
- d. /gj/

16) Cila fonemë ka këto tipare: shtegore, mesore, qiellzore, e tingullt

- a. /nj/
- b. /j/
- c. /l/
- d. /gj/

17) Cila fonemë ka këto tipare: e përparme, e mbyllur, jobuzore

- a. /i/
- b. /e/
- c. /y/

d. /u/

18) Gjeneri zanoren e theksuar në fjalën *akuadrom*

- a. ákuadrom
- b. akúadrom
- c. akuádrom
- d. akuadróm

19) Gjeneri zanoren e theksuar në fjalën *kulluese*

- a. kúlluese
- b. kullúese
- c. kulluéese
- d. kulluesé

20) Gjeneri fjalën tek e cila formohet diftong ngjitës

- a. përrua
- b. skuadër
- c. shiu
- d. shtëpia

21) Gjeneri fjalën tek e cila formohet diftong zbritës

- a. përrua
- b. skuadër
- c. shiu
- d. kuotë

22) Gjeneri fjalën tek e cila formohet tog zanor

- a. përrua
- b. skuadër
- c. shiu
- d. kuotë

23) Theksi i fjalës në gjuhën shqipe është:

- a. dinamik
- b. muzikor
- c. intensiv
- d. i fortë

24) Theksi i fjalës në gjuhën shqipe është:

- a. i ngulitur, i lëvizshëm
- b. i lirë, i lëvizshëm
- c. i ngulitur, i palëvizshëm
- d. i lirë, i palëvizshëm

25) Intonacioni ngjitës është karakteristikë e fjalisë:

- a. pohuese
- b. urdhërore
- c. nxitëse
- d. pyetëse

26) Përcaktoni dukurinë fonetike që ka ndodhur në shembullin *ekzistoj>egzistoj*

- a. metafoni
- b. asimilim
- c. disimilim
- d. metatezë

27) Përcaktoni dukurinë fonetike që ka ndodhur në shembullin *shtëpi>shpi*

- a. epentezë
- b. apokopë
- c. sinkopë
- d. aferezë

28) Përcaktoni dukurinë fonetike që ka ndodhur në shembullin *lisharës>shilarës*

- a. metafoni
- b. asimilim
- c. disimilim
- d. metatezë

29) Përcaktoni dukurinë fonetike që ka ndodhur në shembullin *plak>pleq*

- a. metafoni
- b. apofoni
- c. disimilim
- d. metatezë

30) Përcaktoni dukurinë fonetike që ka ndodhur në shembullin *hedh>hodha*

- a. metafoni
- b. apofoni
- c. disimilim
- d. metatezë

31) Përcaktoni dukurinë fonetike që ka ndodhur në shembullin *sapun>sapu*

- a. epitezë
- b. epentezë
- c. sinkopë
- d. apokopë

32) Përcaktoni dukurinë fonetike që ka ndodhur në shembullin *sapun>sapund*

- a. epitezë
- b. epentezë
- c. sinkopë

d. apokopë

33) Përcaktoni dukurinë fonetike që ka ndodhur në shembullin *pritte>priste*

- a. metafoni
- b. asimilim
- c. disimilim
- d. metatezë

34) Përcaktoni dukurinë fonetike që ka ndodhur në shembullin *film>filëm*

- a. protezë
- b. aferezë
- c. epentezë
- d. epitezë

35) Metafonia ndodh kur një zanore:

- a. nga më e hapur bëhet më e mbyllur dhe nga më e prapme bëhet më e përparme
- b. nga më jobuzore bëhet buzore
- c. nga më e mbyllur bëhet më e hapur dhe nga më e përparme bëhet më e prapme
- d. nga më buzore bëhet jobuzore

36) Apofonia ndodh kur një zanore:

- a. nga më e hapur bëhet më e mbyllur dhe nga më e prapme bëhet më e përparme
- b. nga më jobuzore bëhet buzore
- c. nga më e mbyllur bëhet më e hapur dhe nga më e përparme bëhet më e prapme
- d. nga më buzore bëhet jobuzore

37) Epiteza është:

- a. shtim tingujsh në fillim të fjalës
- b. shtim tingujsh në trup të fjalës
- c. shtim tingujsh në fund të fjalës
- d. shtim tingujsh në fillim dhe në të fjalës

38) Epenteza është:

- a. shtim tingujsh në fillim të fjalës
- b. shtim tingujsh në trup të fjalës
- c. shtim tingujsh në fund të fjalës
- d. shtim tingujsh në fillim dhe në të fjalës

39) Gjatë shqiptimit të grupit *ngj* tek fjala *ngjalë* ndodh dukuria e:

- a. qiellzorizimit
- b. spirantizimit
- c. velarizimit
- d. buzorëzimit

40) Gjatë shqiptimit të grupit *ng* tek fjala *këngë* ndodh dukuria e:

- a. qiellzorizimit

- b. spirantizimit
- c. velarizimit
- d. buzorëzimit

MORFOLOGJI

- 1. Struktura e fjalës dhe fjalëformimi
- 2. Emri dhe mbiemri: Kategoritë gramatikore
- 3. Llojet e përemrave
- 4. Folja
- 5. Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës: Ndajfolja, parafjala, lidhëzat, pjesëzat.

Literatura:

Gramatika e gjuhës shqipe I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2002

E. Likaj, M. Cabej: Morfologji e shqipes standarde, Tiranë, 2010

PYETJET

1. Në sa morfema ndahet fjala *përpunojmë*:

- a. 3
- b. 4
- c. 5
- d. 6

2. Cila është mbaresa e fjalës *kuptuam*:

- a. nuk ka
- b. -m
- c. -am
- d. -uam

3. Te fjala *çlirimtarëve*, **ë-ja** është:

- a. prapashtesë fjalëformuese
- b. prapashtesë trajtëformuese
- c. mbaresë
- d. asnjë prej tyre

4. Cila është tema e fjalës *rivlerësimeve*:

- a. rivlerëso
- b. rivlerësim
- c. rivlerësime
- d. vlerë

5. Në fjalën *lisave*, pjesa e fjalës *lisa* është:

- a. temë e parme

- b. rrënja e fjalës
- c. tema fjalëformuese
- d. tema morfologjike

6. Fjala *përgënjeshtroj* është fjalë e prejardhur:

- a. me parashtesë
- b. me prapashtesë
- c. me konversion
- d. me parashtesë dhe prapashtesë njëkohësisht

7. Cila prej fjalëve të mëposhtme është fjalë e prejardhur e tipit prapashtesor:

- a. lexim
- b. i pavlefshëm
- c. kujtojnë
- d. afër

8. Cili prej bashkimeve të mëposhtme nuk është kompozitë (fjalë e përbërë):

- a. vajtje-ardhje
- b. paradite
- c. OSBE
- d. bregdet

9. *I përpiktë* është fjalë:

- a. e përngjitur
- b. e përbërë
- c. e prejardhur
- d. e formimit të përzier

10. Konversioni është:

- a. lloj morfeme
- b. mënyrë fjalëformimi
- c. tip fjalëformimi
- d. asnjë prej tyre

11. Cila nga pikat e mëposhtme është kriter për dallimin e gjinisë së emrave në gjuhën shqipe:

- a. tingulli fundor i temës
- b. mbiemrat dhe fjalët e tjera përcaktuese
- c. mbaresat rasore të së pashquarës dhe të së shquarës njëjës
- d. të gjitha

12. Cili është emër i dygjinishëm (ambigjen):

- a. term
- b. vajzë
- c. det

d. libër

13. Si dallohet gjinia tek emrat e frymorëve:

- a. me anë prapashtesash
- b. me mënyrën leksikore
- c. me mënyrën leksikore dhe me anë prapashtesash
- d. me mënyrën leksikore, me anë prapashtesash dhe me ndërrime të tingujve të temës

14. Si e ndërtojnë shumësin këta emra: lot, nxënës, shtëpi, muze, qen, deve:

- a. me ndërrim të tingujve të temës
- b. njësoj si njëjësi
- c. me prapashtesë
- d. me ndërrim të tingujve të temës dhe me prapashtesë

15. Cilat janë mbaresat e rasës dhanore të emrave të gjinisë femërore në trajtën e shquar të numrit njëjës:

- a. -s, -së, -ës, -es
- b. -së, -ës
- c. -e, -je
- d. -s, -së, -ës

16. Cilët lakim i përkasin emrat: fëmijë, dajë, axhë:

- a. lakimit të parë
- b. lakimit të dytë
- c. lakimit të tretë
- d. asnjërit prej tyre

17. Sipas kuptimit leksikor, mbiemrat: i rrufeshëm, i gurtë, i sotëm, janë:

- a. marrëdhëniorë
- b. cilësorë
- c. herë cilësorë, herë marrëdhëniorë, sipas kontekstit
- d. të nyjshëm

18. Kur mbiemrat e panyjshëm vendosen pas emrave, nuk kanë kategorinë e:

- a. gjinisë
- b. numrit
- c. rasës
- d. asnjë prej tyre

19. Cili prej mbiemrave në fjalitë e mëposhtme është në shkallën krahasore të sipërisë absolute:

- a. Ato ishin për të ditët më të vështira të jetës.
- b. Dukej jashtëzakonisht i zbehtë, prandaj nuk e ngacmoi më me pyetje.
- c. Rruga m'u duk aq e gjatë, saqë u habita kur i erdhi fundi.
- d. U bë flakë e kuqe dhe nuk nxori dot zë.

20. Mbiemri i bukur në fjalinë: "Sa më shumë kalonte koha, aq më e bukur i dukej ngjarja që kish ndodhur tri ditë më parë", është në shkallën:

- a. pohore
- b. krahasore të barazisë
- c. krahasore të sipërisë relative
- d. sipërore

21. Në cilën prej fjalive të mëposhtme është përdorur përemri dëftor:

- a. Ishte e veçantë ajo ditë.
- b. Në sajë të tij kishin përfituar të gjithë.
- c. Atyre u dukej sikur edhe netët s'kishin të sosur.
- d. Askush nuk foli për ne.

22. Rrethoni variantin ku nuk ka trajtë të shkurtër të përemrit vetor:

- a. I porositi të kishin kujdes.
- b. Është e vështirë t'u lexosh çdo ditë të njëjtën gjë.
- c. Pas pak kohësh të gjithë u larguam nga ai qytet.
- d. Hapeni dritaren, se bën vapë këtu!

23. Përemri ai (përkatësisht ajo, ata, ato) përdoret:

- a. vetëm si vetor
- b. vetëm si dëftor
- c. si vetor dhe si dëftor
- d. si vetor, si dëftor dhe si i pacaktuar

24) Përemri i tillë është:

- a. përemër pronor
- b. përemër lidhor
- c. përemër dëftor
- d. përemër i pacaktuar

25) Përemri pronor jote i gjinisë femërore formohet nga gjinia mashkullore:

- a. duke ndryshuar nyjën
- b. duke ruajtur trajtën e gjinisë mashkullore
- c. me supletivizëm
- d. me mbaresë femërorizuese

26) Rrethoni variantin, ku fjala kush është përdorur si përemër i pacaktuar:

- a. Të flasë kush të dojë.
- b. Trokiti kush?
- c. Nuk e di kush erdhi.
- d. Nuk e mora vesh se me kë udhëtove.

27) Në fjalinë "Nga ç'dëgjoji, kuptoi se gjithçka po shkonte mirë", fjala ç' është:

- a. përemër lidhor
- b. lidhëz

- c. përemër i pacaktuar
- d. përemër pyetës

28) Fjala kur përdoret si:

- a. lidhëz
- b. përemër dhe lidhëz
- c. përemër dhe pjesëz
- d. përemër, lidhëz dhe pjesëz

29) Përemri pyetës sa:

- a. ka kategorinë gramatikore të numrit
- b. ka kategorinë gramatikore të rasës
- c. ka kategorinë gramatikore të numrit dhe të rasës
- d. nuk ka kategori gramatikore

30) Fjala një përdoret:

- a. vetëm si një
- b. vetëm si numëror
- c. si një dhe si numëror
- d. si një, si numëror dhe si përemër i pacaktuar

31. Në fjalinë "Vëllai i saj ishte mjek në atë qytezë", folja jam është:

- a. me vlerë të plotë leksikore
- b. gjysmëndihmëse
- c. ndihmëse
- d. gjysmëndihmëse dhe me vlerë të plotë leksikore

32. Cila prej foljeve të mëposhtme është kalimtare:

- a. Nuk lëvizi asgjë nga vendi.
- b. Nga larg dallohej një tym i zi.
- c. Punonte pareshtur gjithë ditën e ditës.
- d. Nga vinte kjo zhurmë e çuditshme?

33. Rrethoni variantin në të cilin folja është në diatezën mesore:

- a. Vezullimet e dritave ishin përhapur në të katër anët.
- b. U thashë të mos vonoheshin.
- c. U kap keq me të.
- d. Këto lule vyshken shpejt.

34. Nuk është folje e zgjedhimit të tretë:

- a. di
- b. rri
- c. vë
- d. fle

35. Forma foljore qeshë mësuar është në kohën:

- a. e kryer të thjeshtë të dëftores
- b. e kryer të tejshkuar të dëftores
- c. e kryer të kushtores
- d. më se të kryer të dëftores

36) Rrethoni variantin e saktë të së tashmes së habitores të foljes *mësoj*:

- a. mësuakam
- b. mësokam
- c. mësokërkam
- d. mësokësha

37) E kryera e thjeshtë e zgjedhimit jovepror të foljeve ndërtohet:

- a. me foljen ndihmëse *jam*
- b. me pjesëzën *u*
- c. me mbaresa karakteristike
- d. me foljen ndihmëse *jam*, me pjesëzën *u* dhe me mbaresa karakteristike

38) Forma foljore *me të dalë* është formë e pashtjelluar:

- a. pohore
- b. mohore
- c. paskajore
- d. përcjellore

39) E tashmja e lidhore ndryshon nga e tashmja e dëftores:

- a. nga pjesëza *të*
- b. nga tema e njësuar për të gjithë tipat e zgjedhimit
- c. nga pjesëza *të* dhe nga mbaresat e vetës së dytë e të tretë njëjës
- d. nga pjesëza *të*, nga tema e njësuar për të gjithë tipat e zgjedhimit dhe nga mbaresat e vetës së dytë e të tretë njëjës

40) Pjesorja e foljes:

- a. i ka të gjitha kategoritë gramatikore të foljes
- b. nuk ka asnjë kategori gramatikore
- c. ka vetëm kategorinë gramatikore të vetës
- d. ka kategorinë gramatikore të mënyrës, kohës, vetës dhe numrit

41. Në cilën prej fjalive të mëposhtme fjala *larg* është përdorur si ndajfolje:

- a. Nuk jetonte dot larg tyre.
- b. Vinte që larg ajo zhurmë e padurueshme.
- c. Donte të rrinte larg asaj bote të çuditshme.
- d. Larg vendlindjes çdo gjë i dukej e huaj.

42. Cila prej ndajfoljeve në fjalitë e mëposhtme përdoret vetëm në shkallën krahasore:

- a. Pasi kaloj grykën e malit, e mori më shtruar.
- b. Duhej të kishe folur më pak në atë takim.
- c. Nuk e njohu, se nuk e kishte takuar më parë.

d. U largua pa u përshendetur, por do të kthehej më vonë.

43. Në fjalinë: *E kërkoi rreth një orë, po nuk e gjeti, fjala rreth është:*

- a. ndajfolje
- b. emër
- c. pjesëz
- d. parafjalë

44. Në cilin variant fjala ku është përdorur si ndajfolje lidhore:

- a. Ku mendon se do të arrish me këtë që bëre?
- b. Fusha ku kaluam, ishte e mbushur plot me lulëkuqe.
- c. Po ecte kuturu dhe nuk e dinte ku po shkelte.
- d. Drita e zbehtë dallohej më qartë atje ku dilte tymi.

45. Në cilin variant nuk është përdorur ndonjë parafjalë:

- a. Ecte nxitimthi edhe rrëzës së malit, që të arrinte sa më parë.
- b. Ajo lule buiste vetëm në pranverë faqe kodrës.
- c. Revista dilte nga shtypi krye cdo muaji.
- d. Qëndroi bri meje pa thënë asnjë fjalë.

46) Cila nga rasat e mëposhtme nuk përdoret me parafjalë:

- a. emërore
- b. gjinore
- c. dhanore
- d. rrjedhore

47) Lidhëzat në fjali:

- a. nuk shprehin asnjë marrëdhënie
- b. shprehin marrëdhënie barazie dhe varësie
- c. shprehin vetëm marrëdhënie varësie
- d. shprehin vetëm marrëdhënie barazie

48) Në fjalinë: *Nuk ishte ndier kurrë më i lumtur se sot, lidhëza se është:*

- a. bashkërenditëse
- b. nënrenditëse ftilluese
- c. nënrenditëse krahasore-mënyrore
- d. nënrenditëse shkakore

49) Në cilin variant fjala që është përdorur si pjesëz:

- a. Duhet të nxitoj që të arrij para se të ngriset.
- b. Nuk e kishte kuptuar që në fillim se gjërat do të merrnin të tatëpjetën.
- c. Mendoi që të nisej vetëm, se vendi ishte i rrezikshëm.
- d. Do të shkonte edhe vëllai i saj, që ai e kishte takuar disa herë.

50) Pjesëzat:

- a. kanë kuptim leksikor të pavarur

- b. shprehin marrëdhënie gramatikore
- c. shërbejnë si gjymtyrë fjalie
- d. shprehin ngjyrimë kuptimore plotësuese

SINTAKSË

1. Raportet sintaksore. Mjetet gjuhësore të lidhjeve sintaksore dhe shprehjes së këtyre raporteve. Njësitë sintaksore.
2. Natyra e përbërësve dhe kriteret e dallimit të tyre. Marrëdhëniet kuptimore dhe lidhjet sintaksore midis përbërësve. Sintagma kundrejt togfjalëshit.
3. Fjalja, kuptimi, përkufizimi, klasifikimi dhe analizimi sipas tipareve kuptimore dhe sintaksore. Gjymtyrëzimi aktual i fjalisë.
4. Kuptimi i përgjithshëm i gjymtyrëve, klasifikimi dhe llojet e tyre. Gjymtyrë kryesore-gjymtyrë të dyta; gjymtyrë të domosdoshme- gjymtyrë fakultative. Dukuria e homogjenisë dhe e veçimit dhe prania e gjymtyrëve shoqëruese në fjali.
5. Periudha, klasifikimi, periudha bashkërenditëse dhe nënrenditëse: lidhëzore dhe jolidhëzore; korrelative dhe jokorrelative.

Literatura:

Akademia e Shkencave, Gramatika e gjuhës shqipe, II, Tiranë, 1997

M. Totoni, Faza me nënrenditje, Tiranë, 2000

Th. Dhima, Gjuha shqipe, Sintaksa, Tiranë, 2005

M. Çeliku, Tekst ushtrimesh për sintaksën e shqipes standarde, Tiranë, 2008

T. Topalli, Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksa e fjalisë, Shkodër, 2011

PYETJET

- 1) Sa lidhje sintaksore nënrenditëse të përbërësve realizohen në fjalinë: *Treni i mëngjesit u nis me vonesë për Durrës.*
 - a. dy
 - b. tri
 - c. katër
 - d. pesë

2) Sa lidhje sintaksore të drejtpërdrejta realizohen në njësinë: *Erdhën ditë të ngrohta dhe kumbullat e egra çelën lule përnjëherësh.*

- a. dy
- b. tri
- c. katër
- d. pesë

3) Sa lidhje sintaksore nënrenditëse të përbërësve realizohen në fjalinë: *Treni i mëngjesit u nis me vonesë për Durrës.*

- d. dy
- e. tri
- f. katër
- d. pesë

4) Cili nga përbërësit luan rolin e specifikuesit të SF në sintagmën *po lexonte një libër*

- a. emri
- b. nyja
- c. pjesëza
- d. asnjë

5) Cili nga përbërësit luan rolin e plotësorit në sintagmën *shumë njerëz*

- a. përemri
- b. emri
- c. asnjë
- d. sintagma

6) Çfarë është njësia *po shkonte në shtëpi*:

- a. sintagmë
- b. togfjalësh
- c. sintagmë/togfjalësh
- d. fjali

7) Si realizohet lidhja sintaksore midis përbërësve të lidhjes *duke lexuar librin*

- a. me përshtatje
- b. me drejtim
- c. me bashkim
- d. me bashkëpërshtatje

8) Me ç'mjet gramatikor lidhen përbërësit e lidhjes: *lexonte me kujdes*

- a. me eptim
- b. me parafjalë dhe eptim njëherazi
- c. me pranëvënie
- d. me parafjalë

9) Fjalitë *Kthehem pas një ore. është*:

- a. dëftore e mirëfilltë

- b. dëftore thirrmore
- c. nxitëse e mirëfilltë
- d. nxitëse thirrmore

10) Ç'loj fjalie është: *Më thuaj cili vend të ka pëlqyer më shumë?*

- a. pyetëse tërësore e drejtë
- b. pyetëse tërësore e zhdrejtë
- c. pyetëse e pjesshme e drejtë
- d. pyetëse e pjesshme e zhdrejtë

11) Fjalia mohuese *Nuk tha asnjë fjalë shpreh:*

- a. mohim tërësor
- b. mohim të pjesshëm
- c. mohim tërësor të përforcuar
- d. mohim të pjesshëm të dyfishtë

12) Fjalia pohuese: *A mund të futen edhe ata që janë jashtë?*

- a. fjali pohuese e sigurt
- b. fjali pohuese e sigurt e përforcuar
- c. fjali pohuese e pasigurt
- d. fjali pohuese e pasigurt e përforcuar

13) Fjalia *Në derë trokitën për së dyti. është:*

- a. fjali dykryegjymtyrëshe
- b. fjali njëkryegjymtyrëshe foljore vetore me vetë të përcaktuar
- c. fjali njëkryegjymtyrëshe foljore vetore me vetë të të përgjithësuar
- d. fjali njëkryegjymtyrëshe foljore vetore me vetë të papërcaktuar

14) Fjalitë *Është verë*. është:

- a. fjali dykryegjymtyrëshe
- b. fjali njëkryegjymtyrëshe foljore vetore me vetë të përcaktuar
- c. fjali njëkryegjymtyrëshe foljore pavetore
- d. fjali njëkryegjymtyrëshe foljore vetore me vetë të papërcaktuar

15) Cila prej fjalive të mëposhtme është fjali njëkryegjymtyrëshe emërore përshkruese?

- a. Nga mëngjesi.
- b. Ditë e nxehtë vere
- c. Ja universiteti, ja fakulteti.
- d. Në universitet.

16) Fjalitë *Ku po shkon?* është:

- a. fjali e plotë
- b. fjali e paplotë e kontekstit
- c. fjali e paplotë eliptike
- d. fjali e paplotë e situatës

17) Cila prej fjalive të mëposhtme është fjali e pagjymtyrëzueshme e pohimit?

- a. Trang, trang, trang.
- b. Errësirë.

- c. Ëhë.
- d. Shëëët!

18) Në ç'rast, forma e pashtjelluar foljore funksionon si kallëzues foljor i thjeshtë?

- a. Ata janë për t'u lavdëruar për punën e bërë.
- b. U nisën pa zbardhur dita.
- c. Ecnin duke folur vazhdimisht për atë ngjarje.
- d. U bë për t'u martuar.

19) Në ç'fjali dalloni kallëzues emëror?

- a. Kush je ti?
- b. Ai ishte në shtëpi?
- c. Ishte vendosur në Tiranë
- d. Ishte ditë e nxehtë vere.

20) Në cilën fjali kryefjala është e shprehur me një emër në trajtë të pashquar?

- a. Dy maçokë laramanë nisën të ziheshin me potere.
- b. Një mjegull e lagësht e bardhë endej poshtë në luginë.
- c. Çdo njeri do ta kishte të vështirë t'i kuptonte ata të dy.
- d. Në stalla kundërmonte erë bari.

21) Ç'funksion luan mbiemri në fjalinë e mëposhtme?

Zëri i tij u bë i çuditshëm në ato momente.

- a. përcaktor me përshtatje

- b. ndajshtim
- c. përcaktor kallëzuesor
- d. gjymtyrë emërore e kallëzuesit emëror

22) Në cilën fjali kemi kallëzues foljor të thjeshtë të ndërlikuar?

- a. Ky lumë po tkurrej e zvogëlohej.
- b. Ditë e natë atje hynin e dilnin shumë njerëz.
- c. Më kanë mbetur në mend sytë e Mitrushit.
- d. M'u ngulën në tru ora gjashtë dhe emri i kinemasë.

23) Pjesorja në fjalinë e mëposhtme funksionon si:

Rojet e lanë derën e këshjellës hapur.

- a. gjymtyrë emërore e kallëzuesit emëror
- b. rrethanor mënyre
- c. përcaktor kallëzuesor i kryefjalës
- d. përcaktor kallëzor i kundrinorit

24) Sintagma e nënvizuar në fjalinë e mëposhtme funksionon si:

Ajo shkollë e re u ndërtua nga vetë fshatarët

- a. kryefjalë
- b. kundrinor i drejtë pa parafjalë
- c. kundrinor i zhdrejtë me parafjalë
- d. përcaktor kallëzuesor

25) Ç'gjymtyrë fjalie është fjala e nënvizuar? Lumja unë që ia arrita kësaj dite!

- a. kryefjalë
- b. kallëzues
- c. rrethanor
- d. asnjë gjymtyrë

28) Ç'funksion kryen ndajfolja në fjalinë e mëposhtme?

Salla lart ishte tejmbushur me njerëz.

- a. kryefjalë
- b. përcaktor me bashkim
- c. përcaktor kallëzuesor i kryefjalës
- d. rrethanor vendi

29) Në cilën fjali sintagma parafjalore funksionon si kundrinor i zhdrejtë me parafjalë?

- a. Kadriu përpiqej të lexonte pranë të sëmurëve.
- b. Pranë një pylli pishe gjejmë një fshat të madh.
- c. Të dy vëllezërit u vështruan në sy.
- d. Çatia e vjetër prej druri ka pësuar shembje të pjesshme.

30) Gjymtyra e nënvizuar në fjalinë e mëposhtme funksionon si: Pedagog Agroni u emërua dekan.

- a. kryefjalë
- b. përcaktor me drejtim
- c. ndajshkrim

d. përcaktor kallëzuesor

31) Cili është funksioni i gjymtyrës së nënvizuar?

Kohët e fundit e donte më shumë se kurrë.

- a. rrethanor kohe
- b. rrethanor sasie
- c. gjymtyrë e krahasimit
- d. gjymtyrë e veçuar

32) Ç'funksion luan gjymtyra e nënvizuar?

E ka gojën brisk.

- a. rrethanor mënyre
- b. përcaktor kallëzuesor
- c. gjymtyrë e krahasimit
- d. gjymtyrë e veçuar

33) Në cilën fjali, kryefjala luan rolin e remës:

- a. Të gjithë qeshën me shokët e tij.
- b. Ballkoni ishte i shkretë.
- c. Anjë njeri nuk luajti nga vendi
- d. Gjatë ditëve të festivalit do të zhvillohej konferenca shkencore ndërkombëtare.

34) Në cilën fjali, trajta e shkurtër është e domosdoshme?

- a. Vajzat e pëlqenin atë.

- b. Plaka e ngriti rrëmbimthi shkopin.
- c. Ata e panë dje filmin e ri.
- d. Benit po i thahej pështyma!

35) Në cilën fjali kemi praninë e një gjymtyre të dytë të veçuar?

- a. I shumëpritur nga një pjesë e deputeteve, ristrukturimi i partisë ka mbetur vetëm në kuadrin e deklaratave.
- b. Temperaturat e larta janë bërë tashmë pjesë e jetës sonë.
- c. Paci u kthye atë të shtunë nga shkolla me sy të skuqur dhe të lodhur.
- d. Sipas mendimit tim, shqiptarët duhet të jenë tani rreth 9 milion.

36) Çfarë është gjymtyra e nënvizuar në fjalinë e mëposhtme? Margarita, shoqja e tyre, e kishte tradhëtuar.

- a. kryefjalë e veçuar
- b. ndajshim i veçuar
- c. përcaktor me drejtim i veçuar
- d. përcaktor kallëzuesor i veçuar

37) Në cilën fjali nuk janë përdorur gjymtyrë homogjene?

- a. Djaloshi e ndiente veten të lehtë dhe të gëzuar.
- b. Plaku dhe plaka u ulën në krevatin e Memos.
- c. U ngritën dhe lanë sheshin e kishës shkretë.
- d. Ata pinë e kënduan gjithë natën.

38) Fjala e nënvizuar në fjalinë e mëposhtme është?

Në fakt, kjo hap një perspektivë të re për kombin shqiptar.

- a. thirror
- b. gjymtyrë e veçuar
- c. fjalë e ndërmjetme
- d. fjalë e ndërkallur

39) Në cilën fjali është përdorur fjalë/tog fjalësh të ndërkallura?

- a. Dhe, për habi të të gjithëve, ky as e përmend fare diplominin e tij.
- b. Zana u kthye me mall të madh në Gostivar (Kososë)
- c. Me sa duket, forca nuk i mposht dot shqiptarët
- d. Takimi u bë atë ditë, në orën 8 të mbrëmjes.

40) Në cilën fjali vihet re rendi emfatik afektiv (remë+temë)

- a. Karroca u nis.
- b. Te gardhi u duk një njeri.
- c. Njerëzit u mbledhën në sheshin e bashkisë.
- d. Kërkonin një mjedis më të pastër.

41) Njësia kallëzuese e nënrenditur në periudhën e mëposhtme

është?

Mamaja dukej se flutonte nga gëzimi.

- a. fjali e nënrenditur shkakore
- b. fjali e nënrenditur kallëzuese
- c. fjali e nënrenditur mënyrore
- d. fjali e nënrenditur kundrinore

42) Sa njësi kallëzuesore ka periudha e mëposhtme?

Shumë shqiptarë duan të dinë a do të votojnë në zgjedhjet parlamentare që do të zhvillohen në muajin qershor të vitit të ardhshëm.

- a. dy
- b. tri
- c. katër
- d. pesë

44) Segmenti i nënvizuar në njësinë:

Vajza fshiu avullin te xhami dhe pa në mes të xhadësë një fshatar të vogël, veshur me rroba të zeza e të ngushta.

- a. përcaktor i veçuar
- b. rrethor i veçuar
- c. fjali e nënrenditur përcaktore
- d. fjali e nënrenditur rrethore

45) Fjalja rrethore e nënvizuar në periudhën e mëposhtme është?

Ai i shtrohej mësimin natën, kur nuk lozte dot, por, kur mësonte përqendrohej aq shumë, sa as fluturat rreth petromaksit nuk ia hiqnin dot vëmendjen andej.

- a. fjali e nënrenditur kohore
- b. fjali e nënrenditur përcaktore
- c. fjali e nënrenditur shkakore
- d. fjali e nënrenditur kushtore

46) Cila prej njësive të periudhës së mëposhtme nuk është njësi drejtuese?

E vërteta ishte se çdo zbërthyes kishte të drejtë që nga dosja e tij të hiqte mënjanë ato ëndrra që i kishin të pashpjegueshme, të cilat u jepeshin pastaj për shpjegim zbërthyesve të vështirësive, që ishin mjeshtrit e interpretimit.

- a. se çdo zbërthyes kishte të drejtë
- b. që nga dosja e tij të hiqte mënjanë ato ëndrra
- c. të cilat u jepeshin pastaj për shpjegim zbërthyesve të vështirësive
- d. që ishin mjeshtrit e interpretimit

47) Në cilën periudhë që-ja lidh një fjali të nënrenditur shkakore

- a. Fëmija heshte e nuk ankohej për plagën, që i rridhte gjak.
- b. Atij i erdhi keq që s'po e takonte Petritin.
- c. Faji është imi që nuk ia bëra të qarta që në fillim.
- d. Ishte hera e parë që po kthehej nga shkolla dhe nuk po e gjente aty.

48) Në cilën nga periudhat e mëposhtme kemi fjali të nënrenditur rrjedhimore korrelative?

- a. Këta pleq të imtë e emocionuan aq shumë, saqë mezi fliste.
- b. Unë do të shkruaj ca gjëra të çuditshme, saqë do t'ju lënë gojëhapur.
- c. Këmbët u ishin bërë copë, aq sa djersa u kishte dalë mbi rrobe.
- d. Bukuria i mahniti të gjithë, sa askush nuk foli.

49) Në cilën periudhë është përdorur fjali e ndërmjetme?

- a. Ky, ta marrësh vesh mirë zotrote, është Atdheu ynë, ku kemi lerë e ku punojmë me nder.
- b. Motra që ja dinte zakonin, nuk i fliste fare.
- c. Tek po rrinin bashkë, ai foli.
- d. Por, kur u pendova, letra ishte nisur bashkë me pakon.

50. Në cilën nga periudhat e mëposhtme dallohen më shumë fjali asindete?

- a. Riviera fillon në 1000 metra lartësi, në Qafë Llogara rruga zbret e egër nga maja deri në fund.
- b. Koz Dynjaja hyri në të ndarën e zjarrit, qëndroi një çast në mes të saj dhe pastaj thirri djemtë.
- c. Djemtë kishin dalë atë të diel të shikonin të zgjedhunat e zemrës, të përzgjidhnin më të mirën e tyre.
- d. Fanulla u prek, rrëmbeu shtambën, doli përjashta dhe filloi të qante me dënesë.

LEKSIKOLOGJI

- 1. Fjala, vlerat dhe vecoritë e saj në gjuhën shqipe, kuptimi leksikor tipet e tij.
- 2. Klasifikimi i njësive frazeologjike
- 3. Shtresimi i leksikut të shqipes sipas burimit, dukuritë semantike (sinonimia, antonimia, polisemia, homonimia, hiperonimia)

Literatura:

J. Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2006

PYETJET

1) Cila nga njësitë frazeologjike ka vlerë emërore?

- a. burri i botës
- b. (e kam) bukë e djathë
- c. u bë erë
- d. anës e anës

2) Cila nga njësitë frazeologjike ka vlerë emërore?

- a. ëndrra në diell
- b. (u bë) gazi I botës
- c. s'e çon kokën
- d. i jep dorën

3) Cila nga njësitë frazeologjike ka vlerë emërore?

- a. gozhdë në zemër
- b. i hurit dhe i litarit

- c. la kockat
- d. i kreh bishtin

4) Cila nga njësitë frazeologjike ka vlerë emërore?

- a. gur në opingë
- b. kaposh mbi pleh
- c. mori dhenë
- d. i mori shpirtin

5) Cila nga njësitë frazeologjike ka vlerë emërore?

- a. këmbëza e urës
- b. ia mbylli derën
- c. s'ngriti kokë
- d. ngrohet në diell

6) Cila nga njësitë frazeologjike ka vlerë mbiemërore?

- a. kockë e lëkurë
- b. s'e prish gjakun
- c. i punoi qindin
- d. i rropi lëkurën

7) Cila nga njësitë frazeologjike ka vlerë mbiemërore?

- a. mësalë me dy faqe
- b. kërcu mbi samar
- c. petulla me ujë
- d. e solli në vete

8) Cila nga njësitë frazeologjike ka vlerë mbiemërore?

- a. as mish,as peshk
- b. qiçra ne hell
- c. e solli vërdallë
- d. tund derën

9) Cila nga njësitë frazeologjike ka vlerë foljore?

- a. i bën hesapet pa hanxhinë
- b. stan me lepuj
- c. shpirt njeriu
- d. të zitë e ullirit

10) Cila nga njësitë frazeologjike ka vlerë foljore?

- a. i bëj sytë katër
- b. thalë mbi bisht
- c. daulle e shpuar
- d. ha bukën e të përmbys kupën

11) Cila nga njësitë frazeologjike ka vlerë foljore?

- a. e bën veshin të shurdhër
- b. teneqe e shpuar
- c. me buzë varur
- d. me gjak të ftohtë

12) Cila nga njësitë frazeologjike ka vlerë foljore?

- a. ia futi këmbët në një këpucë
- b. me një këmbë në varr
- c. fol e qesh
- d. qesh e ngjesh

13) Cila nga njësitë frazeologjike ka vlerë ndajfoljore?

- a. brez mbi brez
- b. zbardh dhëmbët
- c. nuk ha shqip
- d. pret hollë

14) Cila nga njësitë frazeologjike ka vlerë ndajfoljore?

- a-kodra pas bregut
- b-bluan trashë
- c-i ra prapa
- d-e la pas

15) Ka kuptim leksikor tërësor dhe të mëvetësishëm:

- a. fjala
- b. morfema
- c. fonema
- d. sintagma

16) Ka strukturë të mbyllur:

- a. fjala
- b. togfjalëshi
- c. fonema
- d. morfema

17) Ka vlerë semantike:

- a. fjala
- b. fjalia
- c. kuptimi
- d. koncepti

18) Ka aftësi fjalëformuese:

- a. fjala
- b. fonema
- c. kuptimi
- d. koncepti

19) Fjala *kusi* është një

- a. barbarizëm
- b. arkaizëm
- c. dialektalizëm
- d. neologjizëm

20) Fjala *dyrrotak* është një

- a. barbarizëm
- b. arkaizëm
- c. dialektalizëm
- d. neologjizëm

21) Fjalë që kanë kuptim të afërt ose të njëjtë janë:

- a. sinonime
- b. antonime
- c. homonime
- d. hiperonimie/hiponime

22) Fjalët *këmbë njeriu-këmbë ure-këmbë tryeze*, kanë lidhje:

- a. sinonimie
- b. polisemie
- c. homonimie
- d. hiperonimie/hiponimie

23) Fjalët *verë (stinë e vitit) –verë (pije)*, kanë lidhje:

- a. sinonimie
- b. polisemie
- c. homonimie
- d. hiperonimie/hiponimie

24) Fjalët *peshk-merluc. levrek-kocë-sardele-*, kanë lidhje:

- a. sinonimie
- b. polisemie
- c. homonimie
- d. hiperonimie/hiponimie

25) Fjalët *rreth (figurë gjeometrike) –rreth (unazë)*, kanë lidhje:

- a. sinonimie
- b. polisemie

- c. homonimie
- d. hiperonimie/hiponimie

26) Fjala *gjella* (me kuptimin “jeta”) është një

- a. barbarizëm
- b. arkaizëm
- c. dialektalizëm
- d. neologjizëm

27) Fjala *bashtinë* është një

- a. barbarizëm
- b. arkaizëm
- c. dialektalizëm
- d. neologjizëm

28) Fjala *fëshfërin* është një

- a. onomatope
- b. eufemizëm
- c. huazim
- d. neologjizëm

29) Fjala *qoftëlargu* është një

- a. onomatope
- b. eufemizëm
- c. huazim
- d. neologjizëm

30) Fjala *sabah* është një

- a. barbarizëm
- b. arkaizëm
- c. dialektalizëm
- d. neologjizëm

31) Fjalët *mashkull-djalë-burrë* kanë lidhje:

- a. sinonimie
- b. polisemie
- c. homonimie
- d. hiperonimie/hiponimie

32) Cilat fjalë i përkasin burimit grek?

- a. fier, lakër, mokër
- b. bujk, faqe, fëmijë
- c. flok, fqinj, furrë
- d. çekiç, çudit, dobi

33) Cilat fjalë i përkasin burimit grek?

- a. pjepër, presh, qershi
- b. gusht, janar, këmbë
- c. këngë, kokë, kushëri
- d. fllad, gosti, gozhdë

34) Cilat fjalë i përkasin burimit latin?

- a. mik, mjek, prill
- b. mëndafsh, oreks, i pastër
- c. kockë, kovaç, kovë
- d. krahinë, kyç, lopatë

35) Cilat fjalë i përkasin burimit latin?

- a. prind, qytet, penë
- b. pronë, tipar, stolis
- c. memec, mërzit, neverit
- d. oborr, padit, patë

36) Cilat fjalë i përkasin burimit turk?

- a. perde, raki, sahat
- b. marinar, paguaj, timon
- c. trumbetë, vapor, velë
- d. Novoselë, Pogradec, Zagori

37) Cilat fjalë i përkasin burimit turk?

- a. çarçaf, pazar, penxhere
- b. bankë, bark, batare
- c. fitoj, karrocë, kushton
- d. Bogovë, Çorovodë, Gorishtë

38) Fjalët që shkruhen njësoj, por nuk kanë lidhje kuptimore janë

- a. polisemike
- b. homonimike
- c. antonime
- d. sinonime

39) Shenja gjuhësore që përdoret për të emërtuar përfaqësuesin e një klase quhet:

- a. polisemike
- b. homonimike
- c. hiponim
- d. hiperonim

40) Aftësia e fjalës për të pasur njëkohësisht shumë kuptime quhet:

- a. polisemi
- b. homonimi
- c. antonimi
- d. sinonimi

DIALEKTOLOGJI

1. Përkufizimi i konceptit të dialektit
2. Gjeografia gjuhësore dhe metodat e tjera të studimit të dialekteve
3. Klasifikimi i dialekteve dhe të folmeve të shqipes

Literatura:

- J.Gjinari-Gj.Shkurtaj, *Dialektologjia*, Tiranë, 1996, 2003, 2009
B. Beci, *Dialektet e shqipes dhe historia e formimit të tyre*, Tiranë, 2002
J.Gjinari, *Dialektet e gjuhës shqipes*, Tiranë, 1989

PYETJET

1) Sa dialekte ka gjuha shqipe?

- a. 3
- b. 2
- c. 4
- d. 6

2) Cili është nënsistemi më i vogël i dialektit:

- a. nëndialekti
- b. e folmja krahinore
- c. idiolekti
- d. e folmja vendore

3) Dallimet dialektore krijohen për shkaqe:

- a. të grupeve sociale
- b. të shpërndarjes hapsinore të folësve të një gjuhe
- c. prejardhjes së ndryshme gjuhësore
- d. përkatësisë etnike të ndryshme të folësve

4) Termi *izoerge* përdoret nga Pelegrini për të shënuar shtrirjen e një dukurie:

- a. etnografike
- b. dialektologjike
- c. gjeografike
- d. historike

5) Termi *izoglosa* përdoret nga Pelegrini për të shënuar shtrirjen e një dukurie:

- a. etnografike
- b. gjuhësore
- c. gjeografike

d. historike

6) Si pas Rusëlo (Rouselot), studimi dialektologjik duhet të shoqërohet me atë:

- a. gjenealogjik
- b. klimaterik
- c. sinkronik
- d. psikologjik

7) Pyetësi i parë dialektologjik për shqipen u hartua nga:

- a. Spiro Floqi
- b. Jorgji Gjinari- Bari Beci
- c. Eqrem Çabej
- d. Eqrem Çabej- Mahir Domi

8) ADGJSH ka pasur shtatë synime paraqitjen e:

- a. të gjitha të folmeve të shqipe
- b. të folmeve brenda territorit të RSH
- c. të folmeve të diasporës
- d. vetëm dilekteve dhe nëndialekteve

9) Autort e ADGJSH-së janë:

- a. J. Gjinari, B. Beci, Gj. Shkurtaj, Xh. Gosturani
- b. J. Gjinari, B. Beci, Gj. Shkurtaj, Q. Haxhihasani
- c. J. Gjinari, T. Osmani, Gj. Shkurtaj, Q. Haxhihasani
- d. J. Kastrati, B. Beci, Gj. Shkurtaj, Xh. Gosturani

10) Areali dialektor përbehet

- a. dialekte
- b. idiolekte
- c. nga disa të folme
- d. gjuhë

11) Areali me numrin më të madh të fonemave zanore ka:

- a. 19 fonema zanore
- b. 14 fonema zanore
- c. 21 fonema zanore
- d. 7 fonema zanore

12) Areali me numrin më të vogël të fonemave zanore ka:

- a. 4 fonema zanore
- b. 7 fonema zanore
- c. 3 fonema zanore
- d. 6 fonema zanore

13) Sa u takon zanoreve të theksuara, në të njëjtin areal dialektologjik përfshihet:

- a. e folmja e Matit dhe e Krujës

- b. e folmja e Tiranës dhe e Krujës
- c. e folmja e Përmetit dhe e Labërisë
- d. e folmja e Librazhdit dhe e Mirditës

14) Ne vend të grupit *ua shfaqet ue* në:

- a. të folmen e Kukësit
- b. të folmen e Tiranës
- c. të folmen e Labrisë
- d. e folmen e Durrësit

15) Zëvendësimi i grupeve *mb, nd* përkatësisht me *b/p, d/t* (p.sh. *mblodhëm-blodhëm*) ndodh në:

- a. të folmen e Krujës
- b. të folmen e Tiranës
- c. të folmen e Malësisë së Madhe
- d. e folmen e Durrësit

16) Zëvendësimi i grupeve *tj, dj* përkatësisht me *q, gj* (p.sh. *tjetër-qetër*) ndodh në:

- a. të folmen e Krujës
- b. të folmen e Tiranës
- c. të folmen e Malësisë së Madhe
- d. e folmen e Shkodrës

16) Zëvendësimi i fonemës *dh* përkatësisht me *ll* (p.sh. *llamba-dhamba*) ndodh në:

- a. të folmen e Gjirokastrës
- b. të folmen e Tiranës
- c. të folmen e Labërisë
- d. e folmen e Malësisë së Madhe

17) Zëvendësimi i fonemës *ll* përkatësisht me *dh* (p.sh. *i madh-i mall*) ndodh në:

- a. të folmen e Gjirokastrës
- b. të folmen e Tiranës
- c. të folmen e Labërisë
- d. e folmen e Malësisë së Madhe

18) Shumësi i emrave me *-j* është karakteristikë e:

- a. të folmeve veriore
- b. të folmeve jugore
- c. të folmeve arbëreshe
- d. gjuhës standard

19) Forma pësore e kohëve të përbëra formohet me foljen ndihmëse *kam*, (p.sh. *jam rritur- u kam rritur*) në:

- a. të folmen e Dibrës
- b. të folmen e Mirditës

- c. të folmen e Malësisë së Madhe
- d. e folmen e Krujës

20) Cila nga këto të folme nuk përfshihet në të folmet kalimtare

- a. e folmja e Rajcës
- b. e folmja e Polisit
- c. e folmja e Tiranës
- d. e folmja e Dumresë

SOCIOLINGUISTIKË

1. Bashkësia shoqërore (BSH) dhe bashkësia gjuhësore (BGJ). Përfundime teorike rreth bashkësisë gjuhësore shqiptare. Klasat dhe grupet shoqërore, statusi i shqipes në hapësirat etnike shqiptare. Gjuha dhe shteti, gjuha dhe institucionet shtetërore dhe arsimore e kulturore.
2. Monolingvizmi dhe plurilingvizmi. Gjuhët në kontakt. Dygjuhësia, bilingualiteti dhe diglosia.
3. Sociolinguistika dhe mësimi i gjuhës në shkollë. Teoria e “deficitit verbal”. Teoria e B. Bernshtanjit : *kodi i gjerë* dhe *kodi i ngushtë* ; teoria e *rikompensimit* . Pasurimi i gjuhës.

Literatura:

Gj. Shkurtaç, *Sociolinguistikë e shqipes*, Tiranë, 2009

PYETJET

1) Cili është aspekti dinamik i statusit social?

- a. roli
- b. statusi
- c. individi
- d. dialekti

2) Nëpërmjet identifikimit të pozicionit të individit në bashkësi përcaktojmë:

- a. rolin
- b. statusin
- c. idiolektin
- d. dialektin

3) Cili prej roleve është i parashkruar:

- a. i një beqari
- b. i një babai
- c. i një burri të martuar

d. i një profesori

4) Tërësia e mjeteve gjuhësore që janë në dispozicion të një bashkësie folësish përbën:

- a. repertorin
- b. kompetencen
- c. idiolektin
- d. dialektin

5) Argotë përbëjnë një varietet:

- a. standard
- b. krahinor
- c. shoqëror
- d. funksional

6) Alfabeti që përdorim sot, është vendosur në:

- a. Komisinë Letrare të Shkodrës
- b. Kongresin e Manastirit
- c. Konsultën e Prishtinës
- d. Kongresin e Drejtshkrimit

7) Gjuha standarde duhet përdorur në:

- a. letërsinë artistike
- b. të gjitha gazetatat dhe revistat
- c. në rrjetet sociale-virtuale (facebook, twitter etj)
- d. në tekstet shkollore

8) Kur mësojmë një gjuhë të huaj, veç asaj amtare, jemi në një situatë:

- a. diglosie
- b. bilinguizmi
- c. bilingualiteti
- d. bilinguizmi kolektiv

9) Arbereshët e Italisë jan në një situatë:

- a. diglosie
- b. bilinguizmi
- c. bilingualiteti
- d. monolinguizmi

10) Plurilinguizmi është një situatë e zotërimit:

- a. një gjuhe të huaj
- b. të gjuhës amtare
- c. të shumë gjuhëve
- d. monolinguizmi

HISTORI E GJUHËS SHQIPE

1. Prejardhja e gjuhës shqipe. Hipotezat e ndryshme.
2. Shqipja si gjuhë i.e. dhe ballkanike. Tiparet kryesore
3. Shqipja gjuhë sintetiko- analitike
4. Huazimet e ndryshme në gjuhën shqipe në rrjedhë të shekujve.
5. Emërtimi i gjuhës shqipe dhe shqiptarëve

Literatura:

Çabej 2007: E. Çabej. *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, Tiranë 2007

Demiraj 1986: Sh. Demiraj. *Gjuha shqipe dhe historia e saj*. Tiranë 1986

Demiraj 1999: Sh. Demiraj. *Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmive të gjuhës shqipe*.

Tiranë 1999

1) Weigand në mbështetje të mendimit të prejardhjes trake të shqipes parashtroi:

- a. 10 argumente
- b. 8 argumente
- c. 12 argumente
- d. 6 argumente

2) Nga të gjitha hipotezat në lidhje me historinë e gjuhës shqipe më e argumentuar ngelet:

- a. hipoteza trake
- b. hipoteza ilire
- c. hipoteza trako- ilire
- d. hipoteza dake

3) P. Kreçmer është përfaqësues i prejardhjes së tezës

- a. ilire
- b. dako- mize
- c. trake
- d. greke

të gjuhës shqipe

4) Emërtimi i toponimit Decebalus që lidhet me gjuhën shqipe, shkon në favor të tezës

- a. latine
- b. trake
- c. greke
- d. ilire

5) Georgiev, në lidhje me prejardhjen e gjuhës shqipe, është përfaqësues i tezës

- a. ilire
- b. dako- mize
- c. pellazge
- d. sllave

6) Hartuesi i fjalorit të parë etimologjik të gjuhës shqipe është:

- a. Jokli
- b. Meyer
- c. Hahn
- d. Demiraj

7) Përfaqësues i hipotezës së dyfishtë të prejardhjes ilire dhe trake të shqipes është:

- a. Çabej
- b. Miklosich
- c. Kopitar
- d. Jokli

8) Hipoteza e prejardhjes pellazge të shqipes nis me:

- a. Rrethin Linguistik të Pragës
- b. Gjuhëtarët vjenezë
- c. Autorët arbëreshë të shek XIX
- d. Shkollën Idealiste Neogjuhësore

9) Hipoteza më pak e argumentuar nga ana historike- gjuhësore rreth prejardhjes së gjuhës shqipe është ajo:

- a. trake
- b. ilire
- c. dake- mize
- d. pellazgjike

10) I pari gjuhëtar që argumentoi plotësisht përkatësinë indoevropiane të shqipes është:

- a. Kopitar
- b. Bonfante
- c. Bopp
- d. Meyer

11) Cili prej emrave të gjuhës shqipe është trashëguar nga indoevropianishtja:

- a. teze
- b. hallë
- c. teto
- d. motër

12) Veçori gjuhësore në sistemin gramatikor të gjuhëve indoevropiane ka qenë sistemi:

- a. prej dy gjinish
- b. prej tri gjinish
- c. pa gjini
- d. me vetëm gjininë asnjënjëse

13) Në lidhje me sistemin e lakimit, gjuha shqipe ka ruajtur prej gjuhëve indoevropiane:

- a. të njëjtin numër rasash
- b. ka shtuar dhe pasuruar numrin e rasave

- c. ka më pak rasa
- d. humbi sistemin e lakimit

14) Cila prej fjalëve të poshtëshënuara, nuk i përket trashëgimisë së fondit indoevropian të gjuhës shqipe:

- a. qoshe
- b. bir
- c. ujk
- d. mjekër

15) Numërorët njëzet, dyzet të gjuhës shqipe, janë sisteme numërimi:

- a. indoevropiane
- b. paraindovevropiane
- c. të huazuara vonë
- d. zhvillime të vona të vetë gjuhës shqipe

16) Numërorët e përbërë tridhjetë, pesëdhjetë, gjashtëdhjetë etj., janë të trashëguara nga:

- a. sistemi indoevropian
- b. sistemi paraindovevropian
- c. zhvillime të vetë shqipes
- d. huazime nga turqishtja

17) Cila prej dukurive të poshtëshënuara gjuhësore të shqipes është tipar ballkanik:

- a. prania e zanores **ë**
- b. prania e zanores **y**
- c. prania e zanores **u**
- d. prania e zanores **a**

18) Formimi i kohës së ardhme me ndihmën e foljes ndihmëse “dua” në trajtë të ngurosur është tipar:

- a. mbarëindoevropian
- b. ballkanik
- c. vetëm i shqipes
- d. i huazuar nga anglishtja

19) Pohimi se në Ballkan kemi “një formë gjuhësore me tri lloje lëndësh gjuhësore” është bërë nga:

- a. Çabej
- b. Kopitar
- c. Miklosich
- d. Sandfeld

20) Karakteri indoevropian i shqipes shfaqet në:

- a. të gjitha nënsistemet e gjuhës
- b. në asnjërin prej tyre
- c. vetëm në sistemin fonetik

d. vetëm në sistemin gramatikor

21) Emërtimi i gjuhës shqipe në dokumentet shkrimore në krye të herës del i përdorur:

- a. si ndajfolje
- b. si emër
- c. si mbiemër
- d. si folje

22) Në “Meshari” i Buzukut fjalën *shqip* e hasim:

- a. 10 herë
- b. 1 herë
- c. 12 herë
- d. 6 herë

23) Tek Budi fjalën *shqip* e hasim:

- a. 4 herë
- b. 10 herë
- c. 12 herë
- d. 8 herë

24) Dokumenti i një fshati të Raguzës me shprehjen e një dëshmitari “Dëgjova një zë që thërriste në mal në gjuhën albaneska” i përket shek:

- a. X
- b. XIII
- c. XV
- d. XVI

25) Cila mendohet se është forma fillestare e emërtimit që lidhet me gjuhën shqipe?

- a. shqiptar
- b. shqiptarisht
- c. shqiptari
- d. shqip

26) Fjala *Arbën* lidhet historikisht me emrin e fisit ilir të:

- a. kaonëve
- b. dasaretëve
- c. liburnëve
- d. albanëve

27) Trajta greke e administratës bizantine e emërtimit të shqiptarëve ka qenë:

- a. politis
- b. arbanaski
- c. arvanitas
- d. arbanenses

28) Fjala shqip në gjuhën tonë ka zëvendësuar formën e vjetër të saj:

- a. shqiptarisht
- b. arnautçe
- c. arbërisht
- d. shqiptarçe

29) Huazimet sllave kanë depërtuar në sajë të marrëdhënieve historike me popujt:

- a. latinë e romakë
- b. trakë e dakë
- c. bullgarë e serbë
- d. grekë të vjetër

30) Cila prej fjalëve të poshtëshënuara i përket burimit grek?

- a. grusht
- b. dafinë
- c. timon
- d. muzikë

31) Cila prej fjalëve të poshtëshënuara i përket burimit sllav?

- a. opingë
- b. soprano
- c. farmak
- d. bluzë

32) Cila prej fjalëve të poshtëshënuara i përket burimit roman?

- a. lopatë
- b. frena
- c. fonetikë
- d. tepsi

33) Cila prej fjalëve të poshtëshënuara i përket burimit turk?

- a. kimi
- b. morfologji
- c. fitil
- d. kulaç

34) Prapashtesat *-llarë/-lerë, -li/-lli* i përkasin burimit:

- a. roman
- b. turk
- c. sllav
- d. grek

35) Prapashtesat *-nik, -ishtë*, i përkasin burimit:

- a. sllav
- b. turk
- c. latin
- d. grek

36) Huazimet turke në gjuhën shqipe në pjesën dërmuese të tyre, janë si rezultat i:

- a. kontakteve direkt me shqipen
- b. trashëgimit prej “nënës” së shqipes
- c. kontakteve me bullgarët
- d. depërtimit nga gjuhët fqinje

37) Cila prej fjalëve të poshtëshënuara mendohet se i përket fondit autokton të shqipes?

- a. klishe
- b. byro
- c. nevojë
- d. dardhë

38) Huazimet nga gjuha frënge përfshihen në huazimet:

- a. turke
- b. romane
- c. sllave
- d. greke

39) Huazimet greke janë rezultat i kontakteve të periudhës:

- a. qysh prej kohëve prehistorike e deri më sot
- b. vetëm i kohëve prehistorike
- c. vetëm i kohës së sotme
- d. vetëm asaj bizantine

40) Nga marrëdhëniet e “nënës” së shqipes me gjuhët klasike janë përftuar:

- a. huazimet sllave
- b. huazimet turke
- c. huazimet latine
- d. huazimet trake

41) Shqipja përveç gjuhëve indoevropiane ka pasur edhe kontakte dhe si pasojë huazime edhe nga gjuhë jo indoevropiane si gjuha:

- a. turke
- b. sllave
- c. romane
- d. greke

42) Shqipja ka nisur kontaktet dhe huazimet e ndërsjella me gjuhët sllave qysh prej:

- a. periudhës së Mesjetës
- b. rreth shek VI
- c. kohëve të sotme moderne
- d. pas Luftës së Dytë Botërore

43) Shqipja është një gjuhë:

- a. analitike

- b. sintetike
- c. analitike- sintetike
- d. sintetike- analitike

44) Elementet e sintetizmit në sistemin emëror të gjuhës shqipe i hasim:

- a. në mbaresat rasore
- b. vetëm në mes të fjalës
- c. në parafjalët
- d. në nyjat

45) Reduktimi i rasave në gjuhën shqipe, krahasuar me disa gjuhë të tjera indoevropiane, tregon karakterin:

- a. analitik
- b. sintetik
- c. kentum
- d. satem

46) Rendi i lirë i gjymtyrëve në një gjuhë në fjali shpreh karakterin e saj:

- a. sintetik
- b. analitik
- c. silabik
- d. kentum

47) Format e kohës së ardhme në gjuhën shqipe shprehin karakterin:

- a. sintetik
- b. analitik
- c. satem
- d. silabik

48) Cila prej dukurive gjuhësore të poshtëshënuara tregon tipar të sintetizmit në gjuhën shqipe?

- a. Krijimi i disa formave gramatikore analitike, që pjesërisht ruajnë edhe elemente të analitizmit
- b. Humbja e pjesshme e aftësisë si dhe formave gramatikore për të qenë të vetëmjaftueshme si gjymtyrë fjali
- c. Ngulitja e rendit të disa gjymtyrëve në fjali
- d. Ruajtja e pjesshme e rendit të lirë të dikurshëm të gjymtyrëve të fjalisë

49) Cila prej formave gramatikore përmban elementin e analitizmit në gjuhën shqipe?

- a. koha e tashme e foljes së mënyrës dëftore
- b. koha e pakryer e foljes së mënyrës dëftore
- c. koha e kryer e thjeshtë e foljes së mënyrës dëftore
- d. koha e kryer e foljes së mënyrës dëftore

50) Cila prej formave gramatikore përmban elementin e sintetizmit në gjuhën shqipe?

- a. koha e kryer e thjeshtë e foljes së mënyrës dëftore
- b. koha e ardhme e foljes së mënyrës dëftore

- c. koha e ardhme e përparme e foljes së mënyrës dëftore
- d. koha e kryer e foljes së mënyrës dëftore